



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 134-Janar 2015 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>





Përmbajta:

Këshilli i Drejtorëve, uron fillimin e vitit 2015	3
Fatmir Ademaj, rizgjedhet kryesues i komiteti për komunitete	3
Begaj: 2015 të jetë një vit edhe më i suksesshëm	4
U shënua “Dita e Legalizimit” në Malishevë	5
Januz Kastrati rizgjedhet kryesues i komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport	5
Begaj priti përfaqësuesit e shoqatës të personave të verbër të Kosovës	6
Instituti GAP: Begaj i treti për realizimin e premtimeve	7
Ka filluar mësimi në SHFMU “I.Mazreku”	7
KPF mbajti mbledhjen e radhës	8
Begaj, priti inspektorët shtetëror të minierave dhe mineraleve	9
Komuna mbështet HANDIKOS-in në Malishevë.....	9
Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje po ecën mirë në Malishevë.....	10
Begaj priti zv/kryeministrin dhe ministrin e Kulturës z.Kujtim Shala.....	11
Begaj: 2015-ta dua të jetë vit edhe më i suksesshëm	12
Begaj priti përfaqësuesit e SHHBK “Nena Terezë”	12
Malisheva bëhet me qendër informative, këshilluese dhe trajnuese për bujqësi	13
“Masakra e Malishevës” shënon edhe reagimin e parë të institucioneve kundër regjimit	14
U përurua libri “Rrëfimi për një kohë të vështirë” i autorit Daut Krasniqi	16
Përkujtohen Ali Kryezi dhe Hysni Mazreku, në 25 vjetorin e vrasjes.....	17
Mbledhja e KK-së do të vazhdoj, pas zgjedhjes së kryesuesit	17



Këshilli i Drejtorëve, uron fillimin e vitit 2015

Malishevë, 5 janar

Këshilli i Drejtorëve, i drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Raxhep Mazreku, ka mbajtur sot mbledhjen e parë për vitin 2015, dhe me këtë rast nënkryetari, i ka uruar të gjithë qytetarët, duke ju dëshiruar shëndet dhe suksese në këtë vit. Nënkryetari Mazreku, po ashtu i ka uruar edhe nxënësit, me rastin e fillimit të gjysmë vjetorit të dytë.

Përndryshe në këtë mbledhje, nënkryetari Mazreku, vitin e kaluar e cilësoi një vit të suksesshëm në realizimin e investimeve kapitale, ndërsa uroi që viti 2015, të jetë një vit edhe më i suksesshëm për të gjithë, përderisa kërkoi angazhim edhe më të madh, nga të gjithë, për realizimin e planeve dhe projekteve.

Nga ana tjetër, drejtorët e drejtorive komunale, në vija të trasha kanë paraqitur plane e tyre për vitin 2015 dhe mënyrën e realizimit, dhe janë shprehur të bindur, jo vetën në realizimin e planifikimeve, por edhe në tejkalimin e këtyre planifikimeve.

Fatmir Ademaj, rizgjedhet kryesues i komiteti për komunitete

Malishevë, 5 janar

Komiteti për komunitete ka mbajtur mbledhjen e njëmbëdhjetë të radhës dhe të parën për këtë vit, ndërsa pas vendimit të Kuvendi të Komunës për ristrukturimin e komiteteve, ky komitet përsëri e ka zgjedhur Fatmir Ademajn, si kryesues të komitetit dhe Naser Malishevën, si zëvendës kryesues. Pas ristrukturimit, anëtar i ri i komitetit, është Islam Vrenezi i cili vjen nga radhët e IQM-së, kurse jashtë këtij komiteti ka mbetur D. Foniqi nga radhët e VV-së.

Përndryshe, në mbledhjen e sotme, komiteti ka shqyrtuar raportin një vjeçar të punës, raport i cili u dërgua për shqyrtim në Kuvendin e Komunës, si dhe u bisedua për organizimin e një takimi mes shoqërisë civile, komuniteteve pakicë dhe përfaqësuesve të komiteti dhe Kuvendit të Komunës, si pjesë e planit të punës për janarin e këtij viti.

Në këtë mbledhje, edhe zyrtarja për komunitete dhe kthim, znj.Edona Krasniqi, ka prezantuar raportin njëvjeçar të punës. Bazuar në këtë raport, gjatë vitit 2014 në Komunën e Malishevës, janë regjistruar 35 të riatdhesuar, prej tyre 11 persona janë riatdhesuar në mënyrë vullnetare. Po ashtu sipas këtij raporti, i cili bazohet nga të dhënat e regjistrimit të fundit në vend, në Komunën e Malishevës, jetojnë 37 romë, 6 ashkali dhe 1 amerikan.

Begaj: 2015 të jetë një vit edhe më i suksesshëm

Malishevë, 12 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, i ka uruar të gjitha drejtoritë dhe të gjitha shërbimet komunale, për punë të mbarë në këtë vit, duke kërkuar angazhim edhe më të madh dhe eliminimin e pengesave eventuale që kanë hasur gjatë vitit të kaluar, në mandatin e parë të tyre, si përgjegjës të drejtorive komunale.

“Viti 2015, të jetë edhe më i suksesshëm. Po mundohemi të bëjmë diçka të mirë, po mundohemi të krijojmë një kulturë të punës, të krijojmë rregulla dhe ti respektojmë ato. Tashmë keni një vit përvojë në udhëheqjen e drejtorive dhe nga përvoja e krijuar, kërkoj që të jemi edhe më të përkushtuar në punën tonë. Të angazhohemi në maksimum të gjithë dhe kërkoj që ti elimini të gjitha pengesat që u janë shfaqur gjatë vitit të kaluar”, tha kryetari Begaj, duke ju drejtuar drejtorëve të drejtorive komunale.

Nga ana tjetër, drejtorët e drejtorive, kanë raportuar para kryetarit për punët e kryera gjatë vitit që shkoi dhe përgatitjet e tyre për vitin në vijim. Bazuar në deklaratimet e drejtorive, gjatë vitit që shkoi, buxheti komunal është shpenzuar në masën 98 për qind, të hyrat vetenake në raport me planifikimin, janë realizuar rreth 110 për qind, ndërsa shërbimet komunale, kanë qenë më efektive, është krijuar një imazh më i mirë nga ana e shërbyesve civil dhe ky imazh dhe kjo cilësi, pritet të rritet edhe më shumë gjatë vitit 2015, përderisa nuk janë regjistruar ankesa në raport me ofrimin e shërbimeve komunale.

Menaxhimi i situatës me ethet hemorragjike krime kongo (EHKK), sipas drejtorive përgjegjëse, ka qenë shumë i mirë në vitin e kaluar, ndërsa në vitin 2015, masat për parandalimin e EHKK, do të fillojnë edhe më herët.

Sa i përket investimeve kapitale, në vitin 2014 ka qenë një vllug i madh i punimeve dhe i realizimit të projekteve, kurse këtë vit, janë në fazën përfundimtare planifikimet e prokurimit, në mënyrë që të mos humbet kohë në realizimin e projekteve, që në këtë vit, do jenë po ashtu të shumta, por synim është rritja e cilësisë gjatë realizimit të projekteve.

Sipas drejtorëve të drejtorive, gjatë vitit të kaluar, janë bërë shumë investime në shkolla, në infrastrukturën në përgjithësi, ndërsa nuk kanë munguar investimet edhe në bujqësi, në kulturë, rini e sport, me gjithë sfidat që kanë pasur në realizimin e këtyre projekteve.

U shënua “Dita e Legalizimit” në Malishevë

Malishevë, 12 janar



Iniciuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), kushtuar procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, sot në parkun e qytetit të Malishevës është vendosur tenda për zhvillimin e aktiviteteve “Dita e Legalizimit” ku qytetarët janë informuar me procedurat e legalizimit të ndërtimeve të cilat nuk kanë leje, dhe kushtet që duhet ti plotësojnë për legalizimin e ndërtimeve.

Aktivitetin për legalizimin e ndërtimeve pa leje, e ka përkrahur edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, i cili inkurajoi të gjithë qytetarët, që kanë ndërtim pa leje, të vijnë të informohen dhe ti fillojnë procedurat për legalizimin e ndërtimeve të tyre, brenda ligjeve dhe rregulloreve, për ndërtim.

“Ne duhet të mësohemi të zbatojmë ligjet. Edhe Kosova, është si vendet tjera dhe ne duhet të mësohemi të punojmë dhe të respektojmë ligjet, në këtë rast edhe ligjin për ndërtim, pasi të gjitha ndërtimet duhet të jenë në harmoni me rregullat, me planifikimet dhe me kushtet urbane”, tha mes tjerash kryetari Begaj.

Aktivitetet vazhdojnë me fushatën informimit, në shkollat e mesme, ku do të shpërndahen broshura, me qëllim të informimit sa më të gjerë të qytetarëve.

Januz Kastrati rizgjedhet kryesues i komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport

Malishevë, 12 janar

Komiteti për arsim, kulturë, rini dhe sport, ka mbajtur sot mbledhjen e nëntë të radhës, dhe të parën për këtë vit, ndërsa kryesues i këtij komiteti, përsëri është zgjedhur Januz Kastrati, edhe për këtë vit. Komiteti në mbledhjen e sotme, shqyrtoi disa raporte dhe i rekomandoi për mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Fillimisht, komiteti, shqyrtoi raportin e punës së komitetit për vitin 2014, të cilin pas votimit e rekomanduan për kuvend, e më pas shqyrtuan edhe planin e punës për vitin 2015, të cilin gjithashtu e rekomanduan për kuvend.

Para anëtarëve të këtij komiteti, drejtori i drejtorisë për arsim, Blerim Thaçi, e ka prezantuar rregulloren për bursa, rregullore e cila gjithashtu do të shqyrtohet në kuvend, si dhe drejtoresha për kulturë, rini dhe sport, Blerta Krasniqi, i njoftoi anëtarët e komitetit, për organizimet e komunës, me rastin e shënimit të ngjarjeve të janarit, e që këtë vit, pasi është 25 vjetori masakrës së Malishevës, do të ketë dy ditë aktivitete, më 29 dhe me 30 janar, ndërsa opinioni i gjerë do të njoftohet me kohë me aktivitetet të cilat do të organizohen, lidhur me “Flaka e Janarit” e që në Komunën e Malishevës, lidhet edhe me masakrën e Malishevës.

Begaj priti përfaqësuesit e shoqatës të personave të verbër të Kosovës

Malishevë, 13 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot në zyrën e tij, drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së personave të verbër të Kosovës, z.Mexhid Foniqi, me të cilin biseduan për gjendjen e personave të kësaj kategorie dhe përkrahjen institucionale për këtë kategori të shoqërisë.

Drejtori ekzekutiv i shoqatës, z.Foniqi, fillimisht e falënderoi kryetarin Begaj, për pritjen dhe për mirëkuptimin e tij, në raport me personat të cilët kanë probleme me shikim, si dhe për përkrahjen e vazhdueshme që Komuna e Malishevës, ka dhënë për këtë shoqatë në Malishevë, si dhe shtroi nevojën, për përkrahje edhe të mëtutjeshme. “Zbatimi i tërësishëm i ligjit, do të na ndihmonte shumë, sidomos tek benifitet, të cilat nuk i gëzojnë”, tha drejtori Foniqi.

Nga ana tjetër kryetari Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, duke i përgëzuar për punën që bëjnë si shoqatë, tha se “ndien obligim moral në raport me këtë kategori” dhe sipas tij, “përkujdesja ndaj këtyre kategorive, është një sprovë për institucionet dhe shoqërinë”.

“Mundësitë tona buxhetore, janë shumë të kufizuara, por ne do ti analizojmë të gjitha mundësitë tona buxhetore, në mënyrë që t’iu ofrojmë përkrahje edhe shoqatës në Malishevë, shoqatë të cilën e kemi përkrahur edhe në të kaluarën”, tha kryetari Begaj.



Përndryshe në Komunën e Malishevës, bazuar në të dhënat e shoqatës së personave të verbër, jetojnë 276 persona, të cilët kanë probleme me shikim, dhe janë tërësisht ose pjesërisht të verbër dhe që kanë nevojë për përkrahje.

Instituti GAP: Begaj i treti për realizimin e premtimeve

Malishevë, 15 janar

Në një publikim të bërë nga Instituti për Studime të Avancuara GAP, për realizimin e premtimeve parazgjedhore nga kryetarët e komunave, Komunën e Malishevës, përkatësisht Kryetarin e Komunës, z.Ragip Begaj, e ka radhitur në vendin e tretë në nivel vendi, në realizimin e këtyre premtimeve, ku sipas GAP, Ragip Begaj i ka realizuar 30 për qind të premtimeve brenda vitit të parë të qeverisjes me Malishevën.

Edhe pse të dhënat ende nuk janë përfundimtare nga ky institut, megjithatë, GAP e ka vlerësuar ndër tre kryetarët e komunave, më të mirët në vend në realizimin e premtimeve parazgjedhore, ndërsa bazuar në hulumtimet e tyre, të bëra publike, deri tani kryetari Begaj, njëqind për qind, i ka realizuar premtimet në ndërtimin e çerdhes për fëmijë, përkrahjen e vazhdueshme për bujqit, asfaltimin e rrugëve lokale dhe ndërmarrjen e hapave sistemor dhe të vazhdueshëm kundër etheve hemorragjike, kurse menjëherë pas këtyre vijnë edhe zgjerimi i rrjeteve të ujësjellësve, përmirësimi i gjendjes me ujë për pije, ndërtimi i shkollave dhe të tjera.

Sipas GAP, "Premtimet e kryetarëve të komunave janë nxjerrë nga paraqitjet mediatike të kandidatëve për kryetar komunash gjatë fushatës zgjedhore. Monitorimi i realizueshmërisë së premtimeve ka filluar një vit pas marrjes së mandatit të kryetarit dhe do të vazhdoj deri në përfundim të mandatit”.

Ka filluar mësimi në SHFMU “I.Mazreku”

Malishevë, 19 janar

Sot ka rifilluar mësimi në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, pasi tashmë është rregulluar kalldaja për ngrohje dhe mësimi ka filluar normalisht. Kështu u bë e ditur në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ndërsa objektin e ngrohjes së shkollës, sot e ka vizituar edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, për të parë nga afër funksionimin e ngrohjes në këtë shkollë.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Arsim, z.Blerim Thaçi, procesi mësimor ka filluar normalisht në këtë shkollë, pasi është rregulluar ngrohja. Sipas drejtorit Thaçi, nxënësit e kësaj shkolle, i

kanë humbur tetë ditë mësimi në gjysmë vjetorin e dytë, ndërsa këto ditë të humbura të mësimimit, do të zëvendësohen.



Në përfundim të gjysmë vjetorit të parë, në këtë shkollë, si pasojë e një shpërthimi nga rrjedha e gazit, ka humbur jetën një punëtor teknik, ndërsa ngrohja e re, funksionon me dru, përderisa ngrohja me gaz është larguar edhe nga shkolla e Temeqinës, dhe është kthyer në ngrohje me dru, në mënyrë që të shmanget ndonjë aksident, siç kishte ndodhur në shkollën e Malishevës.

Përndryshe, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, të drejtuar nga kryetari Begaj, drejtorët e drejtorive komunale, kanë raportuar për fillimin e këtij viti, planifikimin e tyre për aktivitetet që do të zhvillojnë gjatë vitit 2015, përderisa kanë marrë përkrahjen nga i pari i komunës, z.Begaj, për realizimin me sukses të projekteve dhe planeve gjatë këtij viti, dhe shmangien e vështirësive që dalin në punë.

KPF mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 20 janar

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), organ i Kuvendit të Komunës së Malishevës, i drejtuar nga kryesuesi i KK-së. z.Enver Hoti, ka mbajtur mbledhjen e radhës (të parën për këtë vit), ku kanë dhënë disa rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, më saktësisht i kanë dhënë shtatë rekomandime, të cilat do të shqyrtohen në seancën e radhës së KK-së.

Rekomandimet e dhëna për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës së Malishevës, janë: Shqyrtimi i propozim ndryshimeve në statutin e komunës, pastaj plani i punës së Kuvendit të Komunës në vitin 2015, të hyrat vetanake të cilat duhet të barten nga viti 2014 në vitin 2015, e që kanë të bëjnë me tejkalimin e të hyrave vetanake, pastaj rekomandime tjera janë edhe tri rregullore, ajo për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2015, rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe rregullorja për bursa për studentë.

Me kërkesën drejtorisë për arsim dhe edukim, për mbledhjen e ardhshme të KK-së, është rekomanduar për shqyrtim caktimi i pagesës së participimit për fëmijët të cilët do të regjistrohen në çerdhe.

Begaj, priti inspektorët shtetëror të minierave dhe mineraleve

Malishevë, 20 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj, ka pritur sot në një takim me karakter njohës, inspektorët shtetëror të Minierave nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), z.Bali Thaçi dhe z.Nasuf Mirena, me të cilët kanë biseduar për bashkëpunimin e ndërsjellë në fushën e shfrytëzimit të resurseve minerale, nga operatorët në territorin e Komunës së Malishevës.

Fillimisht Kryetari Begaj, pasi i falënderoi inspektorët për vizitën, u shpreh i gatshëm për bashkëpunim. “Unë jam i gatshëm që të bashkëpunoj me ju dhe të ndjekim rrugët ligjore, në raport me operatorët të cilët merren me këtë veprimtari, dhe që ata të punojnë me licencë të shfrytëzimit të resurseve minerale, sipas ligjeve në fuqi”, tha Begaj.

Ndërsa Inspektorët shtetëror të Minierave nga KPMM, shprehen interesimin për bashkëpunim, në mënyrë që operatorët të jenë të licencuar dhe të punojnë sipas ligjeve. “Qëllimi ynë nuk është që operatorët të dënohen, mirëpo ata duhet të futen brenda sistemit ligjor të ushtrimit të veprimtarisë, të kryejnë obligimet ndaj Komunës, dhe të mos bien në konflikt me ligjin”, thanë inspektorët. “ Ne duam që gjithçka të shkoj brenda institucioneve, dhe qëllimi i krejt kësaj është që komunën e juaj dhe komunat tjera të i fusim brenda sistemit dhe operatorët duhet ti kryen obligimet e veta. Ti paguajnë obligimet ndaj komunës, të punojnë me punëtorë të rregullt, ti deklarojnë ata dhe të paguajnë kontributet, dhe të punojnë në mënyrë të rregullt e ti shfrytëzojnë në mënyrë të rregullt mineralet” thanë inspektorët Thaçi e Mirena.

Komuna mbështet HANDIKOS-in në Malishevë

Malishevë, 21 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj dhe koordinatoreja e qendrës së rehabilitimit “HANDIKOS” në Malishevë, znj.Feride Hoxha, sot kanë nënshkruar një marrëveshje për vazhdimin e përkrahjes për këtë qendër rehabilituese, edhe për vitin 2015, duke e vazhduar kështu traditën e mbështetjes për këtë qendër e cila ofron shërbime për personat me nevoja të veçanta.



“E kemi obligim, në rend të parë si qytetar, e pastaj edhe si institucion, që ta mbështesim “Handikos”-in, pasi kjo organizatë merret me trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve të pjesës më të ndjeshme të shoqërisë dhe jo vetëm institucionet, por të gjithë duhet të japin kontributin e tyre, për këtë kategori, në mënyrë që edhe ata të jenë të integruar në shoqëri, në mënyrë të barabartë me të gjithë”, tha kryetari

Begaj, me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, për mbështetje të shërbimeve të “HANDIKOS”-it në Malishevë.

Nga ana tjetër, koordinatorja e Qendrës së Rehabilitimit, “HANDIKOS”, znj.Feride Hoxha, e ka falënderuar kryetarin Begaj dhe komunën, “për vazhdimin e mbështetjes për organizatën, pasi ofrimi i shërbimeve për personat me nevoja të veçanta, praktikisht varet nga komuna, sepse pa këtë mbështetje, tash e sa vite me radhë, ne jo që nuk do të kishim mundur të funksionojmë, por edhe këta persona nuk do ti kishin këto shërbime”.

Komuna e Malishevës, në vazhdimësi, e mbështetë Qendrën e Rehabilitimit “HANDIKOS” në Malishevë, në ofrimin e shërbimeve për personat me nevoja të veçanta. Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar, shuma e përkrahjes për vitin 2015, është 22 mijë e 320 euro, për të gjitha shërbimet.

Procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje po ecën mirë në Malishevë

Malishevë, 23 janar

Projekti kombëtar për regjistrimin e ndërtimeve pa leje, përkatësisht procesi i përpilimit të listës së ndërtimeve pa leje, deri më tani po ecën mbarë në Komunën e Malishevës, por luten qytetarët, që të gjithë të vizitojnë Drejtorinë e Urbanizimit, për njoftuar më mirë rreth procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Sipas drejtorit të drejtorisë komunale për urbanizëm, z.Urim Kastrati, “procesi i përpilimit të listës së ndërtimeve, është ecur mirë dhe deri më tani janë evidentuar mbi 1300 objekte pa leje”. Sipas drejtorit Kastrati, duhet të evidentohen të gjitha objektet dhe më pas të nis edhe regjistrimi i objekteve.

“Lusim të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, që të vizitojnë drejtorinë për Urbanizëm, dhe ti marrin informacionet e nevojshme, për procesin e legalizimit të objekteve, përkatësisht regjistrimin e ndërtimeve pa leje”, tha drejtori Kastrati.

Begaj priti zv/kryeministrin dhe ministrin e Kulturës z.Kujtim Shala

Malishevë, 23 janar



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, ka pritur sot zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ministër i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, z.Kujtim Shala. Kjo vizitë, kishte karakter njohës, lidhur me gjendjen e kulturës, rinisë dhe sportit në Komunën e Malishevës, ku u premtua mbështetje nga ana e ministrit.

Në takim, përveç kryetarit Begaj, ishin të pranishëm edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi dhe drejtori i Drejtorisë së Administratës, z.Ekrem Kastrati.

Fillimisht kryetari Begaj, e falënderoi ministrin Shala, për vizitën e bërë sot në Malishevë, vizitë e cila njëherit është edhe e para nga ndonjë ministër, pas formimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Më pas kryetari Begaj dhe drejtoresha Krasniqi, e njoftuan ministrin Shala, me gjendjen e përgjithshme të infrastrukturës, në kulturë, rini dhe sport, gjendjen e rëndë dhe investimet e pakta në këto fusha, si dhe për mundësitë e kufizuara të komunës, për përkrahje më të madhe, me gjithë resurset që ka Komuna e Malishevës, në zhvillimin dhe avancimin e sportit, kulturës dhe mbështetjes për të rinjtë.

Zv/kryeministri dhe ministri i Kulturës, z.Kujtim Shala, tha se vizita ka “karakter njoftues dhe sot ka ardhur të njoftohet me gjendjen aktuale dhe problemet me të cilat ballafaqohet Malisheva, në kulturë, rini dhe sport”. “Jam i interesuar të bashkëpunojmë dhe ndihmojmë konkretisht në të ardhmen”, tha ministri Shala, i cili premtoi mbështetje për projekte në këto fusha, për Komunën e Malishevës.

Ministri Shala, kryetari Begaj, nënkryetari Mazreku dhe drejtoresha Krasniqi, vizituan edhe stadiumin e qytetit në Malishevë, stadium në të cilin është investuar, por ende nuk është funksional, pasi aty duhet të investohet ende në barin e fushës, në sistemin e ujitjes dhe në disa gjëra tjera teknike, në mënyrë që deri në shtator, ky stadium të jetë në funksion të plotë për futbollistët.



Begaj: 2015-ta dua të jetë vit edhe më i suksesshëm

Malishevë, 26 janar

“Viti 2014 ka qenë një vit i suksesshëm, me gjithë vështirësitë që kemi pasur, por ky vit dua të jetë edhe më suksesshëm”, tha Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, në mbledhjen e rregullt të së hënës, të Këshillit të Drejtorëve, me ç’rast kërkoi angazhim më të madh nga të gjithë, në kryerjen e obligimeve të përditshme në raport me përgjegjësit e secilës drejtori.

“Suksesi nuk është i imi, por është sukses i të gjithëve së bashku, dhe me këtë angazhim të përbashkët ne mund të arrijmë, që në këtë vit të jemi edhe më të suksesshëm bashkërisht dhe ti realizojmë të gjitha projektet e parapara”, tha kryetari Begaj.

Kryetari Begaj, kërkoi nga drejtoritë, që të hartojnë projekte, jo vetëm ato që janë të planifikuara me buxhetet e drejtorive, por edhe projekte tjera, të cilat do të mund ti realizojnë përmes donatorëve tjerë.

Në mbledhjen e sotme të qeverisë komunale, u paraqit edhe agjenda e aktiviteteve në kuadër të shënimit të “Flaka e Janarit” në Komunën e Malishevës, e ku këtë vit, në Malishevë, shënohet jubileu i 25 i ngjarjeve të 29 dhe 30 janarit të vitit 1990. Sipas drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, znj.Blerta Krasniqi, për këtë vit, janë paraparë dy ditë aktivitete. Me datë 29 janar, do të organizohet një tryezë, ku pjesëmarrësit do të paraqiten me kumtesa lidhur me këto data, përkatësisht protestës së 29 janarit të vitit 1990 dhe “Masakrës së Malishevës” të datës 30 janar 1990. Ndërsa me 30 janar, Kuvendi i Komunës së Malishevës, do të mbajë një mbledhje të veçantë, për shënimin e 30 janarit, dhe pas mbledhjes do të bëhen homazhe në varreza dhe vizita në familjet e të vvarëve, të 30 janarit të vitit 1990. Në kuadër të këtyre shënimeve, planifikohet të prezantohet edhe botimi i një libri, nga ish kryetari i Komunës së Malishevës në atë kohë, z.Daut Krasniqi, libër i cili i kushtohet ngjarjeve të këtij viti, ngjarje e cila në të njëjtën kohë, shënon edhe kundërshtimin e parë institucional, kundër regjimit të atëhershëm serbo-sllav.

Begaj priti përfaqësuesit e SHHBK “Nena Terezë”

Malishevë, 26 janar

Kryetari i Komunës së Malishevës z.Ragip Begaj dhe nënkryetari z.Rexhep Mazreku kanë pritur sot në një takim përfaqësuesit e Shoqatës Humanitare Bamirëse Kosovare (SHHBK)

“Nëna Terezë” z.Zef Shala, drejtor ekzekutiv i shoqatës, koordinatorin e regjionit të Prizrenit z.Marash Berisha dhe Dalip Halitaj kryetari i degës së shoqatës “Nena Terezë” në Malishevë. qëllimi i këtij takimi ishte bashkëpunimi i shoqatës me Komunën.

Kryetari Begaj me këtë rast tha, “unë e di kontributin e shoqatës “Nëna Terezë”, që e ka dhënë gjatë luftës dhe para luftës, kam qenë i kyçur dhe jam përpjekur të kontribuoj dhe të ta ndihmoj shoqatën, e edhe tani do të përpiqemi që të ju mbështes brenda mundësive tona, si komunë”.

Drejtori ekzekutiv i SHHBK “Nëna Terezë”, z.Zef Shala, paraqiti para kryetarit Begaj kërkesën e shoqatës për bashkëpunim të ndërsjellët të Shoqatës me Komunën e Malishevës. ”SHHBK ”Nëna Terezë” e ka 25 vjetorin e themelimit të saj, dhe shoqata gjithmonë ka qenë me popullin dhe për popullin, dhe që nga pas lufta është duke u marrë me programe zhvillimore të ekonomive familjare, dhe për ta realizuar këtë, në këtë rast neve na duhet edhe ndihma e komunës përmes degës në Malishevë “ tha Shala.

Qëllimi i përgjithshëm i projektit “Rrjeti i sigurisë”, është synimi për krijimin e një rrjeti të sigurisë sociale nëpër komuna tona, përkatësisht zvogëlimin e nivelit të varfërisë në Kosovë. Ky projekt i dedikohet familjeve më të prekura në aspekt social dhe ekonomik të shoqërisë kosovare.

Malisheva bëhet me qendër informative, këshilluese dhe trajnuese për bujqësi

Malishevë, 27 janar



dhe fermer të shumtë malishevas.

Sot, zyrtarisht është hapur qendra informative komunale për këshillime dhe trajnime për bujqit e Komunës së Malishevës. Në ceremoninë e hapjes së kësaj qendre, mori pjesë Kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, drejtori komunal për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, drejtori i departamentit për këshillime dhe trajnime në Ministrinë e Bujqësisë, z.Hysni Thaçi, zyrtari i Bashkimit Evropian në Kosovës, z.Ross Bull

“Kjo qendër informative, besoj që do ti ndihmoj shumë fermerët tanë dhe do të ndikoj në rritjen e prodhimeve vendore në fushën bujqësisë. Ne në të kaluarën kemi jetuar nga prodhimet tona, por sot edhe bujqësia ka ecur përpara me zhvillimet e kohës, ka ecur

teknologjia në bujqësi, dhe sigurisht që edhe ne duhet të përshtatemi me këto zhvillime, si dhe me rregullat e Bashkimit Evropian, aty edhe ku synojmë të hyjmë edhe ne si evropian që jemi”, tha kryetari Begaj, me rastin e hapjes së kësaj qendre informative për këshilla dhe trajnime.

Zyrtari i lartë i Bashkimit Evropian në Kosovë, z.Ross Bull, tha se “BE ka përkrahur ministrinë, për formimin e këtyre qendrave, me qëllim që edhe Kosova, të funksionoj ashtu siç funksionojnë edhe shtetet e Bashkimit Evropian dhe këto shërbime duhet të jenë në harmoni me shërbimet e shteteve që janë në BE”.

Ndërsa drejtori i departamentit për këshillime dhe trajnime në Ministrinë e Bujqësisë, z.Hysni Thaçi, foli për rëndësinë e këtij projekti, përfitimet që kanë fermerët nga këto qendra informative, si dhe falënderoi Bashkimin Evropian për përkrahje të këtij projekti, shumë me rëndësi për bujqit dhe bujqësinë.

Drejtori komunal për bujqësi, z.Hajrullah Mazreku, duke folur për hapjen e kësaj qendre, tha se bashkë me kryetarin, nga viti i kaluar janë zotuar për hapjen e kësaj qendre edhe në Malishevë dhe krijimi të infrastrukturës së nevojshme për funksionimin e kësaj qendre. “Unë e falënderoj Bashkimin Evropian dhe Ministrinë e Bujqësisë për përkrahjen dhe realizimin e këtij projekti, me shumë rëndësi për bujqit dhe për ngritjen e bujqësisë, si dega më e fuqishme ekonomike në Malishevë dhe në vend në përgjithësi”, tha në fund drejtori Mazreku.

U mbajt tryezë me rastin e 25-vjetorit të “Masakra e Malishevës”

“Masakra e Malishevës” shënon edhe reagimin e parë të institucioneve kundër regjimit

Malishevë, 29 janar



dhunës dhe represionit nga sistemi në ish Jugosllavi.

Nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj, sot në Malishevë, u mbajt një tryezë, me rastin e 25 vjetorit të ngjarjes, e cila në opinion njihet si “Masakra e Malishevës”, e ku pjesëmarrësit, përmes kumtesave dhe kujtimeve, dëshmuuan atë ngjarje, si dhe e vlerësuan si njëra prej ngjarjeve më me rëndësi, jo vetëm në Malishevë, pasi për herë të parë, u shënuar një reagim institucional ndaj



Në këtë tryezë, morën pjesë, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, deputeti i Kuvendit të Kosovës, z.Haxhi Shala, ish kryesuesi i KK të Malishevës, në pritje për tu bërë deputet i Kuvendit të Kosovës, z.Enver Hoti, përfaqësues të subjekteve politike në Malishevë, përfaqësues të institucioneve tjera, përfaqësues të klerit fetar, protagonist të ditës së 30 janarit të vitit 1990, historian e studiues, dhe të pranishëm të tjerë.

Fillimisht, kryetari i Malishevës, z.Ragip Begaj, në hapjen e kësaj tryeze, vlerësoi kontributin e Malishevës, në të gjitha periudhat e historisë dhe të zhvillimeve, në përpjekjet e kombit shqiptar për liri. “Malisheva, gjithmonë ka dhënë kontributin e saj, në të gjitha zhvillimet, në të gjitha periudhat. Edhe në 30 janarin e vitit 1990, ngjarje e cila ka rëndësi historike, Malisheva e ka treguar veten, duke e kundërshtuar ashpër vrasjen e qytetarëve të pafajshëm, dhe këtë kundërshtim, e ka bërë edhe në formë institucionale, nga ana e Kuvendit të Komunës. Unë kisha dashur, që tani e tutje historianët të merren me këtë zhvillim historik dhe politik, dhe që historia të shkruhet, pasi ka kaluar koha e mbajtjes mend të historisë”, tha kryetari Begaj në fjalën e tij.

Më pas, prof.Dr. Asllan Krasniqi, u paraqit me një kumtesë, me temën “Jeta në robëri nuk vlen-Liria nuk ka çmim”, lidhur me ngjarjen e 30 janarit 1990, ngjarje e cila shënon, siç tha edhe Krasniqi, një masakër të kryer nga aparati shtetëror i kohës dhe reagimin e parë institucional, të organeve të Kuvendit të Komunës së Malishevës. Ai, më pas e vlerësoi lartë rezistencën e organeve komunale të Malishevës, duke e cilësuar ngjarjen e 30 janarit, si krim kundër njerëzimit.

Ndërsa, njëri nga protagonistët kryesor të asaj kohe, ish kryetari i Komunës së Malishevës, z.Daut Krasniqi, në mënyrë kronologjike, prezantoi ngjarjet e janarit të vitit 1990, demonstratat e qytetarëve të Malishevës, ku sipas tij, barrën e të gjitha këtyre ngjarjeve e barti rinia dhe popullata e Malishevës. “Revolta e qytetarëve, shprehej me protesta, ndërsa pushteti, inskenonte incidente, për ta arsyetuar intervenimin dhe vrasjen e qytetarëve”, tha ish kryetari Krasniqi. Më pas, në kumtesën tij, prezantoi në tërësi përpjekjet e ish sistemit të atëhershëm, për ta penguar reagimin e udhëheqjes së Malishevës, pengimin e udhëheqjes për të komunikuar me qytetarët, dhe përpjekjet, për mos paraqitje të ngjarjes së rëndë, ku u vranë Ali Kryeziu, Hysni Mazreku, një person tjetër i paidentifikuar dhe u lagëson 11 qytetar të tjerë. Pas ngjarjes, Daut Krasniqi, në cilësinë e kryetarit të Komunës, dhe i përkrahur fuqishëm nga deputetët e atëhershëm në Kuvendin e Kosovës, Xhemajli Bajra, Halit Kryeziu dhe Selim Krasniqi, kishin reaguar në mbledhjen e Kuvendit, duke e vlerësuar si masakër atë ngjarje, Ai më pas, tregoi edhe për përpjekjet e tyre, në informimin dhe zbardhjen e ngjarjes, e ku kishin takuar edhe ish kryetarin e Kryesisë së RSFJ-së, Janez Dërnovshek, e ku kishin marrë premtim për zbardhjen e ngjarjes, por e cila ishte penguar nga sistemi i atëhershëm.


Ndërsa ish kryesuesi i KK të Malishevës (tani në pritje për tu bërë deputet në Kuvendin e Kosovës), z.Enver Hoti, duke marrë fjalën në këtë tryezë, foli për përpjekjet e popullit shqiptar, ngjarjet ndër vite, rezistencën aktive dhe rolin e Malishevës në të gjitha këto zhvillime. Sipas tij, “në vitin 1990, pas masakrës së Malishevës, filloi edhe ndarja institucionale e Kosovës, me ish Jugosllavinë dhe Serbinë”. Më pas, Hoti, foli për të gjitha

ngjarjet, ku Malisheva dha një kontribut të jashtëzakonshëm dhe në fund tha, “ndihem krenar me hisen e Malishevës, në historinë e Kosovës”.

Pas këtyre kumtesave, edhe pjesëmarrësit tjerë, prezantuan dëshmi dhe evokuan kujtime nga ato ditë dhe nga ajo ngjarje, ku në Malishevë, policia, vrau tre persona, plagosi 11 të tjerë dhe maltretoi rëndë katër qytetar të Malishevës. Në mesin të vrarëve ishin edhe Ali Kryeziu nga Bubaveci dhe Hysni Mazreku nga Malisheva, familjet e të cilëve, sot u nderuan me mirënjohje nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

U përurua libri “Rrëfimi për një kohë të vështirë” i autorit Daut Krasniqi

Malishevë, 29 janar



Sot në sallën e Kuvendit të Komunës së Malishevës, u bë përurimi i librit “Rrëfimi për një kohë të vështirë (tragjedia dhe krenaria e Malishevës)”, i autorit Daut Krasniqi (ish kryetar i Komunës së Malishevës në vitin 1990), libër i cili i kushtohet ngjarjeve të janarit të vitit 1990 dhe “Masakrës së Malishevës”.

Ky libër, siç thanë folësit, i kushtohet një ngjarjeje të rëndësishme historike dhe politike, në trevën e Malishevës dhe të Kosovës, ku përmes dëshmive, paraqitet ngjarja dhe zhvillimet tjera lidhur me atë ngjarje, të vitit 1990, e cila shënon e reagimin e parë institucional të Malishevës, kundër sistemit dhe kundër dhunës ndaj banorëve të pafajshëm.

Redaktori i librit, z.Xhevat Sylja, një prezantimin e tij tha se “në këtë libër, kujtohet një ngjarje me rëndësi. Përmes librit dëshmohet një e vërtetë, e pa fryrë por shumë reale. Libri i kushtohet një periudhe të rëndë të historisë, ku represioni kishte arritur kulmin dhe kur ne është dashur ti kundërvihemi këtij represioni, e kjo është paraqitur shumë mirë në këtë libër përmes dëshmive dhe është bërë një ndriçim i një periudhe të caktuar kohore dhe historike”.

Ndërsa prof.Deli Thaçi, në fjalën e tij rreth librit, e përgëzoi autorin, për siç tha “punën e bërë” dhe librin e vlerësoi si një botim me vlera historike dhe politike.

Kurse vet autori, z.Daut Krasniqi, i falënderoi të gjithë ata që kanë ndihmuar, përmes kontributit të tyre, qoftë përmes dëshmive të tyre apo mbledhjes së dëshmive. Po ashtu falënderoi edhe të gjithë ata që ndihmuan në botimin e librit, si dhe redaktorin Xhevat Sylja.

Autori Krasniqi, falënderoi edhe Komunën e Malishevës, për mbështetje dhe në organizimin për përurimin e librit.

Përkujtohen Ali Kryezi dhe Hysni Mazreku, në 25 vjetorin e vrasjes

Malishevës, 30 janar



Me një mbledhje të veçantë, të Kuvendit të Komunës së Malishevës, me nderime në vendin e vrasjes dhe homazhe në varrezat e tyre, sot u përkujtuan Ali Kryeziu dhe Hysni Mazreku, të vrarë më 30 janar të vitit 1990, në Malishevës, nga forcat policore serbo-sllave. Ngjarja e 30 janarit të atij viti dhe kjo masakër, shënojnë edhe fillimin e kundërshtimit institucional, ndaj regjimit të atëhershëm.

“Gjatë tërë historisë së vet, populli shqiptar ka derdhur gjak, në përpjekjet tona, për çlirimin e trojeve shqiptare nga okupatorët. Edhe në vitet e '90-ta, prapë u dashtë të derdhet gjaku, pasi populli shqiptar vazhdoi rezistencën ndaj okupatorit. Okupatori, mendonte se përmes vrasjeve, mund ta shuaj rezistencën e popullit shqiptar, por tek ne gjithmonë ka ndodhur e kundërta, pasi vrasjet, neve na bënin edhe më të fortë. Kështu ndodhi edhe me vrasjen e Ali Kryeziut dhe Hysni Mazrekut, vrasja e cila neve na bëri edhe më të fortë, dhe vazhduam luftën tonë për liri. Edhe sot, pas 25 vjetëve, ne i kujtojmë me nderimet më të larta Ali Kryeziun dhe Hysni Mazrekun, dëshmorët e demokracisë, familjet të cilëve, edhe në luftën e fundit të UÇK-së, pothuajse të gjithë, ishin të kyçur në luftë”, tha në fjalën e tij, Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ragip Begaj.

Ndërsa, ish kryesuesi i KK të Malishevës, z.Enver Hoti, tha se “rënia e tyre, ishte flaka e parë, ishte shenja e fillimit të një rezistence t gjerë kundër okupatorit”. “Okupatori, gjithmonë ka zgjedhur “janarët” për tu munduar ti shuaj lëvizjet e rezistencës, por nuk ja arriti kurrë”, tha Hoti, në fjalën e tij, me rastin e shënimit të 25 vjetorit të “masakrës së Malishevës” dhe rënies së Ali Kryeziut dhe Hysni Mazrekut.

Pas kësaj mbledhje, janë bërë nderime në vendin e rënies në “Sheshin e Dëshmorëve” në Malishevë, dhe janë bërë homazhe në varrezat e tyre në Bubavec dhe Malishevë.

Mbledhja e KK-së do të vazhdoj, pas zgjedhjes së kryesuesit

Malishevë, 30 janar

Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur sot, të parën për këtë vit, i ka trajtuar vetëm dy pika të rendit të ditës, miratimin e procesverbalit dhe të ndryshme, ndërsa pikat tjera të kësaj mbledhje, do të mbahen në një ditë tjetër, pasi me pëlqimin e anëtarëve të



KK-së, paraprakisht, duhet të zgjidhet kryesuesi i ri, pasi ish kryesuesi z.Enver Hoti, është në procedurë për certifikim, për deputet në Kuvendin e Kosovës.

Kryesuesi i deritanishëm, Enver Hoti, është pritje të certifikimit për tu bërë pjesë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa paraprakisht, ka dhënë dorëheqje të qenit anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Me këtë rast, të gjithë folësit në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Komunës, e kanë uruar z.Hoti për postin e ri dhe e kanë uruar për përfaqësim të denjë të qytetarëve të Komunës së Malishevës, në Kuvendin e Kosovës, përderisa e kanë falënderuar për punën dhe bashkëpunimin e deritanishëm, si kryesues i KK të Malishevës.

Mbledhjen e sotme dhe vazhdimin e saj, deri në zgjedhjen e kryesuesit të ri, e ka udhëhequr anëtari më i vjetër i KK të Malishevës, z.Aziz Thaçi.